

Raporti i Progresit, mes kritikave dhe lëvdatave

FAQE 7

Deputetët e opozitës kanë shprehur shqetësim për të gjeturat e Raportit të Progresit, duke thënë se situata nuk ka ndryshuar fare prej raportit të fundit. Opozita i ka bërë thirrje Qeverisë që vërejtjet e këtij raporti t'i marrë seriozisht



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

OVLUÇK-ja: TË HETOHEN RASTET E MANIPULIMIT TË LISTAVE TË VETERANËVE F. 6

HARADINAJ KËRKON SERIOZITET NË PËRBALLJE ME GJENDJEN NË SHËNDETËSI F. 6

GAZMEND LUBOTENI, KRYETAR I KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË F. 11

EKONOMI

DOGANA RRIIT NUMRIN E KUNDËRVAJTJEVE F. 8

VESELI: RRUGA KLINË E EPËRME - KOMORAN TA MARRË EMRIN E SHABAN POLLUZHËS F. 9

KULTURË

KOSOVA, PJESË E EKSPOZITËS NDËRKOMBËTARE TË BIENALES SË VENEDIKUT F. 12

SPORT

LLAPI SYNON T'IA NDALË HOVIN DEDITËS F. 13

SOT GARAT E GJIMNASTIKËS NË FUSHË-KOSOVË F. 13



FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM REKA ■ FAQE 4-5

Serbia në BE, Kosova në OKB

Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, profesori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Blerim Reka, ka bërë me dije se Raporti i Progresit dha dy mesazhe për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor. Mesazhi i parë, se BE-ja nuk do të pranojë anëtar të ri pa zgjidhjen e problemeve të vjetra ndërfqinjësore bilaterale në mes të shteteve të Ballkanit. Dhe, mesazhi i dytë, se BE-ja nuk do të pranojë shtet të reja anëtare pa dekriminalizimin e tyre. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Serbia nuk do të mund të bëhet anëtare e BE-së pa e njohur Kosovën. Kjo, sipas Rekës, i është bërë e qartë Serbisë edhe në Raportin e fundit të Progresit. Sipas tij, në gjysmë të negociatave për anëtarësim në BE, Beogradi do të detyrohet ta zhbllokojë anëtarësimin e Kosovës në OKB si parakusht për anëtarësimin e Serbisë në BE

Opozita: Platforma për dialog, e varfër dhe me shumë të meta

Platforma shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë po shihet me skepticism nga subjektet opozitare. Përfaqësuesit e LDK-së dhe

Vetëvendosjes e kanë quajtur të varfër në përmbajtje këtë platformë. Ndërsa analistët politikë kanë thënë se në esencë platforma është autorizim për vazhdimin

e dialogut në formatin e ri, që udhëhiqet nga presidenti, por që obligohet të bashkëpunojë ngushtë me kryeministrin dhe me gjithë spektrin politik ■ FAQE 3



Shpend Maxhuni, drejtor i AKI-së

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj të premtën kanë emëruar Shpend Maxhunin në

postin e drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), i cili deri më tash drejtonte Policinë e Kosovës ■ FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magdoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është takuar në Sofje me homologen bullgare Ekaterina Zahareva

Yaharieva: Kosova do të jetë e pranishme në Samitin e Sofjes

Sa i takon pjesëmarrjes së Kosovës në Samitin e Sofjes, ministria e Jashtme bullgare Ekaterina Zahareva tha se do të gjejnë një mënyrë që ta ruajë koherencën, elementët protokollarë të një forumi të Bashkimit Evropian, duke respektuar dinjitetin e Kosovës

PRISHTINË, 20 PRILL - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, gjatë takimit në Sofje me homologen bullgare Ekaterina Zaharieva, ka vlerësuar se Kosova dhe Bullgaria kanë nivel shumë të lartë të bashkëpunimit dypalësh, i cili duhet të shtohet veçanërisht në planin ekonomik.

Të dy homologët trajtuan vazhdimin e ndihmës së Bullgarisë në shtetndërtimin e Kosovës, rritjen e pranisë së kompanive nga ky vend, si dhe ndërmjetësimin bullgar për zhbllokimin e Marrëveshjes së interkonieksionit midis Kosovës dhe Serbisë.

Pacolli ka falënderuar të gjitha institucionet bullgare për ndihmën e deritanishme, duke kërkuar mbështetjen e këtij vendi dhe në kuadër të Samitit të Sofjes.

Ministria Zaharieva ka pohuar se do të angazhohej që në Samitin e Sofjes të merrnin pjesë gjithë të

ftuarit e nivelit të lartë nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor.

Sa i takon pjesëmarrjes së Kosovës në këtë samit, ajo tha se "ne do të gjejmë një mënyrë që ta ruajmë koherencën, elementët protokollarë të një forumi të Bashkimit Evropian, duke respektuar dinjitetin e Kosovës".

Pacolli kërkon përkrahjen e Bullgarisë për anëtarësim në Interpol

Ministri i Mbrojtjes së Bullgarisë, Krasimir Karakachanov, ka thënë të premtën se Sofja zyrtare do të vazhdojë bashkëpunimin reciprok dhe mbështetjen për Kosovën. Këto komente ai i ka bërë gjatë një takimi me shefin e diplomacisë së Kosovës, Behgjet Pacolli, me të cilin ka biseduar për zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve duke shfrytëzuar korridorin e tetë. Me këtë rast, Pacolli e ka falënderuar ministrin



Karakachanov për mbështetjen bullgare dhënë për Kosovën. "Ne e kishim zgjidhje të vetme për ta siguruar ekzistencën tonë, shpalljen e pavarësisë dhe ju ishit të parët që e njohët, në një ndërmarrje të vështirë. Pres nga Bullgaria mikpritje të plotë për Kosovën në Samitin e Sofjes në mes të BE-së

dhe Ballkanit Perëndimor", ka thënë Pacolli.

Pacolli ka kërkuar mbështetjen e Bullgarisë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. "Një Kosovë në Interpol është shërbim për një rajon të sigurt", ka thënë Pacolli. Ministri Pacolli ka marrë pjesë edhe në Forumin e Biznesit të

odave të tregtisë dhe industrisë të Kosovës dhe Bullgarisë. Presidenti i Odës bullgare, Zvetan Simeonov, përshëndeti dy ministrat dhe bëri thirrje për nxitjen e bashkëpunimit mes dy vendeve që janë kaq afër. Ai vlerësoi integrimin evropian të vendit të tij që dha efekte në rritjen e ekonomisë bullgare.

Presidenti Meta dekreton Ligjin për Diasporën



TIRANË, 20 PRILL - Pas miratimit në kuvend, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, dekretoi Ligjin për Diasporën, i cili mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, për pjesëmarrje më aktive në zhvillimet e vendit amë.

Ligji për Diasporën, ndër të tjera, ka për qëllim përcaktimin e rregullave për kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet

me diasporën, krijimin e Këshillit koordinues të diasporës, ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor dhe arsimor të pjesëtarëve të diasporës.

Mbi bazë të këtij ligji, organet përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën janë: Këshilli i Ministrave, i cili përcakton politikat e vendit të origjinës për diasporën dhe mënyrat e politikat

për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit shqiptar; ministri përgjegjës për Diasporën, i cili, ndër të tjera, propozon nxjerrjen e akteve rregulluese dhe masa të tjera të nevojshme për marrëdhënien me diasporën; mbikëqyr zbatimin e strategjisë për diasporën, bashkëpunon me Ministrinë e Kulturës dhe Punëve të Jashtme për ngritjen e qendrave kulturore, etj.

Erdogani takon kryeparlamentarin Xhaferi

ANKARA, 20 PRILL - Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, ka pritur në takim kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Ankara. Takimi është zhvilluar me dyer të mbyllura dhe ka zgjatur rreth 40 minuta.

Presidenti Erdogan ka ofruar përkrahjen e Turqisë për integrimin e Maqedonisë në NATO, si edhe

qëndrimin parimor në drejtim të përdorimit të emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Ai ka theksuar se Turqia është ndër shtetet e para që ka njohur Maqedoninë me emrin kushtetues dhe që ka hapur ambasadën në këtë vend.

Njëkohësisht presidenti turk ka folur edhe për nevojën e shtimit të bashkëpunimit ekonomik, duke

riafirmuar angazhimin që këmbimi vjetor tregtar ndërmjet Turqisë dhe Maqedonisë të rritet në një miliard dollarë.

Ndërsa kryeparlamentari Talat Xhaferi ka shprehur kënaqësinë që Republika e Maqedonisë dhe ajo e Turqisë konfirmojnë miqësinë tradicionale dhe përforcojnë bashkëpunimin e suksesshëm shumëvjeçar.



Opozita: Platforma për dialog, e varfër dhe me shumë të meta

Platforma shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë po shihet me skepticizëm nga subjektet opozitare. Përfaqësuesit e LDK-së dhe të Vetëvendosjes e kanë quajtur të varfër në përmbajtje këtë platformë. Ndërkohë analistët politikë kanë thënë se në esencë platforma është autorizim për vazhdimin e dialogut në formatin e ri, që udhëhiqet nga presidenti, por që obligohet të bashkëpunojë ngushtë me kryeministrin dhe me gjithë spektrin politik

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 PRILL - Presidenti Hashim Thaçi të premten ka pranuar nga kryeministri Ramush Haradinaj platformën shtetërore të Republikës së Kosovës për finalizimin e dialogut me Serbinë. Me këtë rast, Thaçi ka thënë se finalizimi i dialogut është një mundësi e mirë për Kosovën që të afrohet me Bashkimin Evropian dhe ta forcojë edhe më shumë subjektivitetin ndërkombëtar. "Kjo fazë e dialogut duhet të përmbyllet me një marrëveshje ligjore ndërkombëtarisht të obligueshme, e cila i mundëson Kosovës anëtarësimin në OKB, por edhe normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial, si dhe duke ecur përpara pa u penguar si shtete fqinje drejt integriteteve euroatlantike", ka Thaçi pas takimit me Haradinajn.


Presidenti Thaçi ka thënë se ekipi i Kosovës në këtë fazë përfundimtare të dialogut do të jetë gjithëpërfshirës si dhe do të ketë bashkëpunim e koordinim të plotë të të gjitha institucioneve të vendit. "Ne jemi të përkushtuar të kontribuojmë në stabilitetin rajonal dhe në krijimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me të gjitha vendet fqinje", është shprehur Thaçi.

Ndërkohë partitë opozitare janë shprehur të pakënaqura me përmbajtjen e platformës shtetërore të Republikës së Kosovës për finalizimin e dialogut

me Serbinë.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka vlerësuar se ky dokument është i varfër në përmbajtje pasi, sipas tij, nuk definojnë as temat për diskutim, as parimet dhe as afatet kohore. Po ashtu, ai ka shprehur pakënaqësinë lidhur me rolin që i jep kjo platformë presidentit në procesin e dialogut, duke theksuar se ky rol i atribuohet atij në mungesë të fuqisë së koalicionit qeverisës për t'i udhëhequr proceset madhore të vendit. "Platforma e re për dialog me Serbinë është e varfër në përmbajtje, nuk definojnë temat, parimet dhe afatet. Nuk përfshihen çështjet kryesore: të pagjeturit, kompensimi i dëmeve, kthimi i pensioneve etj. Dialogu i lihet në dorë presidentit, që reflekton pafuqinë e koalicionit të pakicës për t'i udhëhequr proceset madhore. LDK-ja do të marrë vendim, në konsultim me grupin parlamentar. Një gjë është e qartë, se Qeveria e pakicës nuk mund të dialogojë për çështje nacionale. Nuk do të lejojmë që njerëz të etur për pushtet, që nuk përfaqësojnë shumicën e qytetarëve të Kosovës, të dialogojnë në emër të Kosovës", ka deklaruar Hoti në konferencën javore të grupit parlamentar të LDK-së.

Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ismajl Kurteshi, ka kritikuar përmbajtjen e kësaj platforme duke thënë se ka shumë të meta. Ai ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se si e tillë kjo platformë nuk do ta marrë mbështetjen e Kuvendit të



Maliqi: Platforma, autorizim për finalizimin e dialogut

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se platforma shtetërore për finalizimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë në esencë është autorizim për vazhdimin e dialogut në formatin e ri, që udhëhiqet nga presidenti i vendit, por që obligohet të bashkëpunojë ngushtë edhe me kryeministrin dhe me gjithë spektrin politik. "Kjo platformë po kështu shkurtimeisht përkujton objektivat kryesore në procesin e finalizimit: autorizohet zhvillimi i bisedave politike për arritjen e marrëveshjes ligjore ndërkombëtarisht të obligueshme që, pos normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi, duhet të përfundojë edhe me njohjen reciproke të dy shteteve që nuk cenojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës.

Kosovës. "Platforma ka shumë të meta dhe gjëra të cilat janë të papranueshme për ne. Kjo platformë duhet të vijë në Kuvend, ku subjektet politike duhet të përcaktohen për të. Në fakt, platforma për bisedime me Serbinë duhet të jetë shumë më ndryshe nga kjo që është prezantuar dhe

Po kështu, si rrjedhojë, delegacioni i Kosovës obligohet që në marrëveshje të përfshihet edhe anëtarësimi i Kosovës në OKB, pra njohja e plotë ndërkombëtare e Kosovës. Presidenti, të cilit i njihet roli udhëheqës në finalizimin e dialogut, obligohet të raportojë në baza të rregullta Kuvendit të Kosovës dhe, në paragrafin e fundit, konstatohet se autoriteti suprem për finalen e dialogut, përkatësisht marrëveshjen politike, mbetet Kuvendi i Kosovës, i cili edhe duhet ta ratifikojë marrëveshjen", ka deklaruar Maliqi për gazetën "Epoka e re". Ai ka theksuar se kjo platformë është një dokument i parimeve që vendos vijat e kuqe të objektivave, por nuk jep shumë elemente të zgjidhjeve konkrete të çështjeve

siç është Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. "Për këtë supozohet se mjaftojnë vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, që në shumë aspekte e kanë kritikuar formulimet në platformën për Asociacionin e Komunave Serbe, që kufizojnë aspiratat e Beogradit që AKS të ketë ingerenca ekzekutive vetjake. AKS duhet të jetë organ konsultativ, koordinues dhe që parashtron ankesa për cenimin e të drejtave të komunitetit serb në Kosovë, gjithnjë në kuadër të subordinimit institucional, sistemit dhe normave kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ky dokument është i qartë rreth vijave të kuqe që mbrojnë sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës", është shprehur Maliqi.



miratuar nga Qeveria. Ata po e quajnë platformë, po ky është vetëm një lloj propozimi sepse platforma duhet të përmbajë elemente të tjera. Nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve derisa nuk insistohet dhe nuk arrihet që Kosova të pranohet shtet i pavarur nga Serbia. Prandaj kjo platformë nuk do ta marrë mbështetjen e Kuvendit", ka deklaruar Kurteshi. Megjithatë, ai ka thënë se ky propozim mund të plotësohet me sugjerimet e subjekteve politike dhe në fund mund të dalë një platformë si duhet. "Partitë politike në Kuvend mund të diskutojnë dhe t'i japin propozimet e tyre për të plotësuar këtë propozim. Ne si Vetëvendosje ende nuk jemi ulur të diskutojmë se cilat do të jenë propozimet tona, por natyrisht se do t'i kemi sugjerimet në lidhje me platformën e bisedimeve dhe

një pjesë e tyre tanimë janë të njohura për opinionin", ka theksuar Kurteshi. Sipas Kurteshi, do të ishte mirë që partitë politike shqiptare të arrijnë një konsensus për dialogun me Serbinë. Ai ka shprehur optimizëm se ky konsensus mund të arrihet në rast se synohet normalizim i vërtetë i marrëdhënieve në mes të dy vendeve. "Mendoj se do të ishte mirë të arrihet një konsensus politik karshi Serbisë nga subjektet politike shqiptare. Se sa është e mundur një gjë e tillë, është mjaft e vështirë, megjithatë mendoj se është e mundur nëse synohet që normalizimi të jetë i vërtetë dhe jo të mbetet vetëm në mënyrë deklarative, kurse në anën tjetër të realizohen synimet e Serbisë. Nëse Serbia synon në realizimin e ndarjes së Kosovës që ka filluar një herë me decentralizimin e tash me asociacionin, do të ketë probleme", ka deklaruar Kurteshi.

Flet për "Epokën e re", Blerim Reka

Serbia në BE, K



Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, profesori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Blerim Reka, ka bërë me dije se Raporti i Progresit dha dy mesazhe për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor. Mesazhi i parë, se BE-ja nuk do të pranojë anëtar të ri pa zgjidhjen e problemeve të vjetra ndërfaqinësore bilaterale në mes të shteteve të Ballkanit. Dhe, mesazhi i dytë, se BE-ja nuk do të pranojë shtete të reja anëtare pa dekriminalizimin e tyre. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Serbia nuk do të mund të bëhet anëtare e BE-së pa e njohur Kosovën. Kjo, sipas Rekës, i është bërë e qartë Serbisë edhe në Raportin e fundit të Progresit. Sipas tij, në gjysmë të negociatave për anëtarësim në BE, Beogradi do të detyrohet ta zhblllokojë anëtarësimin e Kosovës në OKB si parakusht për anëtarësimin e Serbisë në BE

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 PRILL - Ish-ambasadori i Maqedonisë në Bruksel, njëherësh profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka deklaruar se raportit i progresit ia ka bërë të qartë Serbisë se pa e njohur Kosovën nuk mund të bëhet

anëtare e Bashkimit Evropian (BE). Ai ka vlerësuar se në gjysmë të negociatave për anëtarësim në BE, Serbia do të detyrohet ta zhblllokojë anëtarësimin e Kosovës në OKB si parakusht për anëtarësim në BE. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka deklaruar se kur të vijë te negociimi i kaptinës 35, Serbia do t'ia dëshmojë BE-së se çfarë shteti është

dhe cilët janë kufijtë e saktë të saj. "Normalizimi i raporteve me Kosovën nuk është vetëm parakusht politik, por është edhe kusht teknik, që del nga kaptina 35 e 'acquis communautaire'. Pa definimin e kufijve të saktë dhe të qartë, Serbia nuk mund të anëtarësohet në BE. Besoj se në gjysmë të procesit negociator, brenda dy vjetësh, Serbia do të

detyrohet ta njohë Republikën e Kosovës, do të detyrohet ta zhblllokojë anëtarësimin e Kosovës në OKB si parakusht për anëtarësim në BE. Me fjalë të tjera, kancelarja Merkel dhe BE-ja ia kanë bërë shumë qartë opsionin Serbisë: Serbia në BE, Kosova në OKB", ka thënë Reka.

Ai ka vlerësuar se vetë fakti që në raport thuhet se normalizimi i marrëdhënieve duhet të përfundojë me një marrëveshje obliguese juridike, nënkuptohet se njohja reciproke është e pashmangshme. "Për të qenë të kujdesshëm, ata ndoshta në këtë fazë të parë nuk e thonë decidivisht njohjen reciproke, përkatësisht njohjen e Republikës së Kosovës. Mirëpo çfarëdo zbrëthimi, çfarëdo interpretimi juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar i këtij formulimi nga raporti i progresit dhe i dokumenteve të mëparshme nga dialogu i Brukselit, ku thuhet

në përfundim me një marrëveshje juridike, udhëzon në nënshkrimin e traktit shtetëror Serbi-Kosovë", është shprehur ai.

Duke folur për raportin e fundit të progresit për vendet e rajonit, Reka ka vlerësuar se kërcënimet gjeopolitike e rikthyen Ballkanin në orbitën e politikës së zgjerimit të BE-së. Sipas tij, në këtë raport BE-ja ka sjellë dy mesazhe për vendet e Ballkanit Perëndimor.

"Epoka e re": Z Reka, Komisioni Evropian ka publikuar Raportin e Progresit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Si e keni parë këtë raport?

Reka: Fillimisht duhet thënë se ky raport e vërteton tezën time të mëhershme, se procesi i zgjerimit të BE-së mbetet proces gjeopolitik dhe më pak teknik. Kjo shihet me riaktivizimin e këtij procesi vetëm para një viti kur u pa se kërcënimet gjeopolitike në dhe rreth Ballkanit

Kosova në OKB



orbitën e politikës së zgjerimit të BE-së.

"Epoka e re": Sa ka qenë real raporti për këto vende?

Reka: Ky raport është teknik. Komisioni Evropian vetëm lëshon raporte 90 deri 100 faqe teknike, por ato nuk janë politike. Vendimi politik do të merret në muajin qershor, në Samitin e Këshillit Evropian, kur shtetet anëtare do të vendosin nëse do t'i pranojnë raportet e Komisionit Evropian. Gjatë historisë ka ndodhur shpesh që raportet e KE-së kanë qenë pozitive, por në fund Këshilli i BE-së ka vendosur në mënyrë negative dhe anasjelltas. Megjithatë, Raporti i Progresit i KE-së për secilin vend kandidat paraqet një prerje njëvjeçare, në këtë rast gati dyvjeçare, sepse Raporti i fundit i Progresit është botuar në vjeshtën e vitit 2016 për të arriturat e vendeve kandidatë në 35 kaptinat e "acquis communautaire". Normalisht se ka pakënaqësi nga shtetet anëtare, shembull nga kjo që u publikua për gjashtë shtetet kandidatë të BE-së duket se më të gëzuarit duhet të jenë Shqipëria dhe Maqedonia, për të cilat KE-ja ka rekomanduar fillimin e negociatave për anëtarësim. Në Serbi dhe Mal të Zi duket se raporti zbehi pak ngazëllim, duke shprehur vërejtjet dhe pakënaqësitë në ritmin jo aq të shpejtë të reformave. Ndërsa, në fund, me vlerësime me të rënda kaluan Bosnja Hercegovina dhe Kosova, si dy shtete që duhet të punojnë më tepër për reformim.

"Epoka e re": Cili mendon se ka qenë mesazhi kryesor i BE-së për këto vende përmes këtij raporti?

Reka: Pa hyrë tash në elaburimin e 35 kaptinave për secilin shtet, mendoj se ky raport ka emituar dy mesazhe për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor. Mesazhi i parë është se BE-ja nuk do të pranojë anëtar të ri pa zgjidhjen e problemeve të vjetra ndërfqinjësore bilaterale në mes të shteteve të Ballkanit. Me fjalë të tjera, BE-ja nuk do ta përsërisë gabimin që bëri me Qipron në vitin 2004. Pra, BE-ja nuk do më import të problemeve ballkanike brenda unionit. Derisa mesazhi i parë është politik, mesazhi i dytë është i brendshëm, institucional. Mesazhi i dytë i BE-së është se ky unionin nuk do të pranojë shtete të reja anëtare në BE pa dekriminalizimin e tyre. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë shpresë për asnjë shtet të ri anëtar të BE-së, pa luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pa çlirimin e shtetit nga kapja dhe

pa ndërtimin e një gjyqësori të pavarur. Pra, BE-ja dëshiron shoqëri të dekriminalizuar nga brenda dhe regjionalisht shoqëri që nuk kanë çështje të hapura kufitare, identitare, territoriale apo etnike midis fqinjëve.

"Epoka e re": Në bazë të kësaj i bie se Serbia nuk do të mund të integrohet në BE pa i normalizuar raportet me Republikën e Kosovës?

Reka: Jo. Këtë herë në Raportin e Progresit për Serbinë vetëm u vërtetua ajo që kancelarja Merkel tri ditë para publikimit të këtij raporti i tha personalisht Vuçiqit në Berlin, se pa njohjen e Kosovës dhe pa normalizimin e raporteve me Kosovën, Serbia nuk mund të presë anëtarësim në BE. Kjo jo vetëm pse është një deklaratë verbale politike e kancelares gjermane, por sepse Serbia gjatë procesit negociator, kur të fillojë t'i hapë dhe t'i mbyllë 35 kaptinat e "acquis communautaire", sidomos kur të vijë te kaptina 35, ajo duhet t'i dëshmojë BE-së se çfarë shteti

është, çfarë kufijsh ka, dhe a i ka kufijtë e definuar. Mbajtjen pengë të Kosovës në botën virtuale të Serbisë vetëm në preambulën e saj kushtetuese nuk do ta pranojë BE-ja sepse, nëse t'i thua në dispozitat juridiko-kushtetuese se ke pjesë të territorit dhe nuk e ushtron sovranitetin me asnjë institucion shtetëror, atëherë defitivisht Serbia nuk do të mund të anëtarësohet në BE. Normalizimi i raporteve me Kosovën nuk është vetëm parakusht politik, por është edhe kusht teknik, që del nga kaptina 35 e "acquis communautaire". Pa definimin e kufijve të saktë dhe të qartë, Serbia nuk mund të anëtarësohet në BE. Besoj se në gjysmë të procesit negociator, brenda dy vjetësh, Serbia do të detyrohet ta njohë Republikën e Kosovës, do të detyrohet ta zhblokojë anëtarësimin e Kosovës në OKB, si parakusht për anëtarësim në BE. Me fjalë të tjera, kancelarja Merkel dhe BE-ja ia kanë bërë shumë qartë opsionin Serbisë: Serbia në BE, Kosova në OKB.

"Epoka e re": Ky normalizim i raporteve Kosovë - Serbi do të thotë edhe njohje reciproke në mes të dy shteteve?

Reka: Edhe në raport thuhet 'normalizimi i marrëdhënieve duhet të përfundojë me një marrëveshje obliguese juridike'. Ky formulim tipik i Brukselit nënkupton që nuk mund të ketë normalizim vetëm verbal pa një traktat ndërshtetëror, bilateral, me fuqi obliguese juridike. Vetëm marrëveshjet apo traktatet ndërshtetërore kanë fuqi obliguese juridike. Kjo është porosia. Për të qenë të kujdesshëm, ata ndoshta në këtë fazë të parë nuk e thonë decidivisht njohjen reciproke, përkatësisht njohjen e Republikës së Kosovës. Mirëpo çfarëdo zbrëthimi, çfarëdo interpretimi juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar i këtij formulimi nga Raporti i Progresit dhe i dokumenteve të mëparshme nga dialogu i Brukselit, ku thuhet në përfundim me një marrëveshje juridike, udhëzon në nënshkrimin e traktit shtetëror Serbi - Kosovë.



Shpend Maxhuni, drejtor i AKI-së

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj të premtën kanë emëruar Shpend Maxhunin në postin e drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), i cili deri më tash drejtonte Policinë e Kosovës. Maxhuni u emërua për një mandat pesëvjeçar, i cili mund të vazhdohet edhe një herë.

Shpend Maxhuni ishte emëruar drejtor i Policisë në vitin 2011, ndërsa është pjesë e Policisë së Kosovës që nga viti 1999. Para Maxhunit, në postin e shefit të AKI-së ishte Driton Gashi, i cili dha dorëheqja pas kërkesës së kryeministrit Haradinaj për ta liruuar detyrën, pas aferës së deportimit misterioz të gjashtë shtetasve turq.

Haradinaj kërkon seriozitet në përballje me gjendjen në shëndetësi

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 20 PRILL - Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Shëndetit, të premten është mbajtur një tryezë me temën "Mbulimi shëndetësor i përgjithshëm: për të gjithë, kudo". Në këtë tryezë ishin të pranishëm edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili. Kryeministri Haradinaj ka thënë se tema mbi shëndetësinë është me rëndësi të madhe dhe duhet trajtuar në përmbajtje, në mënyrë që problemet e tjera të dalin në dritë. "Edhe pse kemi ndarë 20 milionë buxhet shtesë për shëndetësinë, prapë kjo nuk është zgjidhja magjike", ka thënë kryeministri Haradinaj. Duke vlerësuar situatat nëpër të cilat kalon sektori i shëndetësisë, kryeministri Haradinaj ka përmendur disa si më të rëndësishmet, atë nëpër të cilën përballen mjekët dhe personeli teknik, për të cilët tha se janë heronjtë e këtij vendi.

Ai ka thënë se situata tjetër është se infrastruktura në shëndetësi është e vjetër dhe mungojnë gjërat elementare, mungojnë barërat, lista e gjatë e pritjeve të



pacientëve e shumë të tjera. "Por, tani e shoh një seriozitet në përballje me gjendjen në shëndetësi dhe i ftoj të gjithë partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, që ta përmirësojmë gjendjen në shëndetësi", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se në ministrinë që drejton është rritur niveli i llog-

aridhënies, është përmirësuar menaxhimi i Shërbimit Spitalor Universitar Klinik të Kosovës dhe është duke u punuar për rregullimin e sektorit farmaceutik. "Kemi konkretizuar Fondin e Sigurimeve Shëndetësore duke bërë transparentë hapat që duhen ndërmarrë përmes një komunikimi transparent me publikun", ka thënë ministri Ismaili,

duke theksuar se në Qeverinë e Kosovës është marrë vendimi për themelimin e bordit për sigurime shëndetësore, që hapë rrugën për parakushtet që duhen plotësuar për sigurimet shëndetësore.

Dr. Ardita Tahirukaj, shefe e Zyrës së OBSH-së në Prishtinë, ka theksuar se shëndeti është pasuria jonë më e madhe dhe nuk duhet të shihet si një luks i cili mund të

gëzohet vetëm nga më të privilegjuarit. "Ne të gjithë përfitojmë në aspektin social, ekonomik dhe nga ai mjedisor nga një botë e cila synon shëndet për të gjithë. Është koha që së bashku t'i përshejtojmë përpjekjet tona për ta arritur qëllimin e përbashkët për mbulim shëndetësor të përgjithshëm edhe në Kosovë", ka thënë Tahirukaj.

Jagxhillari: Komuniteti turk është i përkushtuar për forcimin e shtetit



PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të premten ka pritur një delegacion nga komuniteti turk i Kosovës për nder të "Ditës së Komunitetit Turk në Kosovë". Duke i uruar të gjithë qytetarët e komunitetit turk për ditën e tyre, presidenti Thaçi ka thënë se komunitetet e pasurojnë shoqërinë tonë me festat dhe kulturën e tyre. "Kosova është atdhe i të gjithë qytetarëve dhe bashkëjetesa jonë, duke i kaluar bashkë jo vetëm festat, por edhe vështirësitë e tjera, e bën shoqërinë tonë edhe më të fortë", u shpreh presidenti Thaçi.

Ndërsa Mahir Jagxhillar, kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës dhe kryesues i këtij delegacioni, ka theksuar se bashkëjetesa dhe toleranca kanë traditë shekullore në Kosovë. "Komuniteti turk është i përkushtuar për forcimin e shtetit të Kosovës, të demokracisë dhe shoqërisë sonë", ka thënë Jagxhillar. Presidenti Thaçi e falënderoi delegacionin turk edhe për kontributin e vazhdueshëm në institucionet e vendit. Pas pavarësisë së Kosovës, 22 prilli është caktuar si Dita e Turqve dhe në Ligjin për Festat Zyrtare është caktuar si Ditë Memoriale.

OVLUÇK-ja: Të hetohen rastet e manipulimit të listave të veteranëve

Prishtinë, 20 prill (ER) - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së përmes një komunikate për medie ka inkurajuar organet e drejtësisë për vënien para përgjegjësisë të gjithë ata që kanë shkelur ligjin, që kanë kryer vepra penale dhe kanë manipuluar listat e veter-

anëve. "OVLUÇK-ja është kundër fushatës së mediave dhe individëve të caktuar, që përmes rasteve individuale t'i njollosin të gjithë veteranët e luftës së UÇK-së. Përgjegjësia penale është individuale dhe të gjithë ata që kanë kryer vepra duhet të përgjigjen para ligjit, pavarë-

sisht se çfarë kategorie të qytetarëve u takojnë", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së. OVLUÇK-ja ka shprehur gatishmërinë të bashkëpunojë me prokurorinë e shtetit, për të hetuar dhe zbardhur të gjitha rastet e manipulimit me listat e veteranëve.



Kuvendi i Kosovës mbajti seancë të jashtëzakonshme për Raportin e Progresit

Raporti i Progresit, mes kritikave dhe lëvdatave



Deputetët e opozitës kanë shprehur shqetësim për të gjeturat e Raportit të Progresit, duke thënë se situata nuk ka ndryshuar fare prej raportit të fundit. Opozita i ka bërë thirrje Qeverisë që vërejtjet e këtij raporti t'i marrë seriozisht. Kurse deputetët e pozitës kanë theksuar se kanë parë shumë përparime të evidentuara në të gjeturat e raportit, derisa nuk e kanë parë të udhës që kaq me nguti kjo seancë e jashtëzakonshme të thirret nga opozita

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 PRILL - Të gjeturat e Komisionit Evropian për Kosovën, të publikuara në Raportin e Progresit, kanë përplasur të premtën, gjatë një seance të jashtëzakonshme, deputetët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e partive në pushtet dhe atyre në opozitë. Kjo seancë është thirrur nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe ka marrë mbështetjen edhe të deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Deputetët e opozitës kanë shprehur shqetësim për të gjeturat e raportit duke thënë se situata nuk ka ndryshuar fare prej raportit të fundit. Deputetja e LV-së, Albulena Haxhiu, ka thënë një Qeveri normale duhet t'i marrë kritikën në raport dhe t'i thërrasë mendjes. "Menjëherë pas publikimit të raportit për vendin, Qeveria u ngut të thotë se ky është raporti më pozitiv që ka pasur ndonjëherë Kosova. Secila Qeveri normale raportin dhe kritikën në këtë raport do t'i merrte seri-

ozisht", ka thënë ajo.

Haxhiu ka shtuar se nëse ekzekutivi nuk e merr këtë raport seriozisht, vendi do të vazhdojë me problemet e njëjta. Ndërsa ka thënë se pajtohet me vërejtjet e deputetëve që teksti i raportit nuk është përkthyer. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, duke kritikuar Qeverinë, ka theksuar se ajo është treguar joserioze në raport me proceset që lidhen me integrimin evropian. "Raporti e qartëson se Qeveria e Kosovës që nga shtatori i vitit 2017 nuk ka dërguar asnjë sinjal bindës që është shtet serioz dhe i kryen përgjegjësitë që i ka. Si rezultat i kësaj gjendje, dalja e koso-varëve nga izolimi nuk ka ndodhur ende. Te kriteret politike, derisa ai i vitit 2016 e përmend polarizimin mes Qeverisë dhe opozitës që është normale, raporti i fundit i vë në dukje polarizimet në mes të koalicionit qeverisës dhe brishtësinë e koalicionit i cili tashmë ka humbur edhe shumicën e thjeshtë", ka thënë Hoti.

Pavarësisht prej vlerësimeve të opozitës nga partitë në pushtet, raporti i fundit i Komisionit Evropian është shikuar nga një prizëm tjetër.

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se sheh shumë përparime të evidentuara në të gjeturat e raportit. "Raporti për vendin ka njohur progresin e institucioneve të Republikës së Kosovës sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe ka pasur vlerësim pozitiv në të ashtuquajturat 'Track Records', posaçërisht në rastet e ashtuquajtura të profilit të lartë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar", ka thënë Deliu-Kodra.

Thirrja e seancës së jashtëzakonshme për të debatuar të gjeturat e raportit të Komisionit Evropian, sipas deputetit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuqi, ishte e panevojshme ngaqë, sipas tij, aty s'kishte asgjë të jashtëzakonshme. "Çka ka të bëjë këtu me çështje të jashtëzakonshme? Kush e ka thirrur këtë seancë e ka bërë shkeljen e kësaj rregulloreje sepse në materialin e thirrjes nuk kemi arsyetim se pse është kjo seancë e jashtëzakonshme. E para ka të bëjë me mungesën e përkthimit të materialit në gjuhën shqipe dhe propozoj që kjo seancë të jetë e anglishtfolëse", ka deklaruar Kuqi.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kjo seancë është thirrur me nguti. "Ftesa për një seancë të shpejtë për raportin e progresit mendoj se është gabim prej anës juaj, ngaqë mendoj se një raport i tillë kërkon një analizë më seri-

oze", ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se nuk do të flasë për të arriturat, por për sfidat, duke paralajmëruar plan veprues nga Qeveria.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se liberalizimi i vizave mund të ndodhë para pushimit të verës. "Liberalizimi i vizave ka për të ndodhur para pushimit të verës", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, është më e rëndësishme të flitet për sfidat sesa të arriturat që janë theksuar në Raportin e Progresit.

Kurse ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se është koha e fundit që të gjithë ta kuptojnë rolin e tyre në procesin e integritimit evropian, pavarësisht çfarë funksioni mbajnë. "E kemi raportin për vendin dhe sfidat e identifikuar, po ashtu e kemi Agjendën Evropiane të Reformave dhe MSA-në si dokumente udhërrëfyese. Le të krijojmë një konsensus nacional për të gjitha çështjet dhe reformat që janë pjesë e këtyre dokumenteve dhe të ecim para", ka potencuar ministrja Hoxha.

Pas debatit, deputetja Fitore Pacolli-Dalipi, në emër të iniciuesit të debatit, paraqiti rekomandimet, të cilat, në mungesë kuorumi, nuk u hodhën në votim. Pas kësaj, drejtuesi i seancës mbylli punimet. Këtë vit Komisioni Evropian ka konstatuar politizim të administratës publike, përhapje të korrupsionit, gjendje të papërmirësueshme të sistemit të arsimit, rritje të papunësisë dhe probleme të theksuara në segmentin e ruajtjes së mjedisit. Po ashtu, Komisioni Evropian ka kërkuar më shumë punë nga institucionet e Kosovës në luftën kundër pastrimit të parave si dhe ka tërhequr vërejtjen për kërcënimin e gazetarëve.

Reçica: S'do të ndalemi derisa punëtori ynë të ketë siguri në punë

**EPOKA
ERE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 PRILL - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka lansuar të premtën fushatën vetëdijesuese "Siguria dhe shëndeti në punë mbi të gjitha", që ka për qëllim parandalimin e rrezikut dhe aksidenteve në vendin e punës. Me këtë rast ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ka vizituar kompanitë e ndërtimeve "Agro Trade-Fidola Construction" dhe "Dreni Sh.p.k", ku ka takuar punëtorët dhe pronarët e kompanive në fjalë dhe ka bashkëbiseduar rreth rëndësisë së zbatimit të legjislacionit në fuqi, si parakushte për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Pronarët e kompanive dhe punëtorët falënderuan ministrin për vizitën dhe interesimin që po tregon për përmirësimin e kushteve të punëtorëve dhe

rritjes së sigurisë në vendin e punës. "Të enjten filluam projektin e punësimit të qytetarëve të cilët gëzojnë asistencë sociale, ndërsa sot po fillojmë një fushatë që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në vendet e punës. Siguria, shëndeti dhe marrëdhënia e rregullt e punës janë standarde që duhen respektuar", ka thënë ministri Reçica.

Ai ka thënë se MPMS-ja ka miratuar një sërë rregulloresh në harmoni me direktivat e BE-së dhe tash po angazhohet fort për zbatimin e tyre. Po ashtu, ai ftoi të gjithë bizneset dhe punëmarrësit ta zbatojnë legjislacionin në fuqi. "Nuk do të rreshtim derisa punëtori ynë të ketë siguri dhe shëndet në punë. Do të jemi të pakompromis ndaj të gjithë atyre të cilët nuk zbatojnë standardet e përcaktuara sipas legjislacionit për siguri dhe shëndet në punë", ka deklaruar ministri Reçica.



Dogana rrit numrin e kundërvajtjeve



Dogana e Kosovës ka njoftuar se në këtë vit ka rritur numrin e zbulimeve të aktiviteteve ilegale për 47 për qind më shumë sesa në vitin e kaluar. Kundërvajtjet doganore tek lojërat e fatit deri tani kanë arritur në 75 raste apo 47 për qind më shumë se në tremujorin e 2017-s

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Në kuadër të parandalimit të veprimtarive ilegale, Njësitë e Doganës që nga fillimi i vitit kanë rritur kontrollat duke rritur numrin e zbulimeve të aktiviteteve ilegale për 47 për qind më shumë se në vitin e kaluar.

Dogana ka njoftuar se si rrjedhojë e kontrolleve të shtuara

dhe rritjes së zbulimeve, kundërvajtjet doganore tek lojërat e fatit deri tani kanë arritur në 75 raste apo 47 për qind më shumë se në tremujorin e 2017-s. "Kemi pasur edhe një mori aparate të konfiskuara, respektivisht 129 copë apo 69 për qind më shumë se në vitin 2017. Gjithashtu, janë konfiskuar

edhe pajisje të tjera si shtëpiza, printer, TV apo 132 copë, pra 59 për qind më shumë se në vitin 2017. Rritja e aksioneve ka rritur edhe vlerën e mallrave të konfiskuara në 154 700.35 euro si dhe të aktvendimet me gjobë për kompanitë që operojnë me baste pa licencë në 39 raste, ku vlera e gjobave të shqiptuara ka arritur në 65 552.00 euro", është thënë në njoftimin e Doganës.

Në këtë njoftim bëhet me dije se ulja e aktiviteteve ilegale si rezultat i punës së Doganës ka ndikuar që bizneset legjitime të kësaj fushe t'i rrisin pagesat e taksave për 49 për qind, ku janë inkasuar 3,7 milionë euro nga ky sektor.

Lokacioni për shitjen e druve në Gjakovë do të jetë prapa "Urës së Tabakëve"

GJAKOVË, 20 PRILL (ER) - Bordi i drejtorëve të Komunës së Gjakovës ka mbajtur të premtën mbledhjen e vet të rregullt, në të cilën janë diskutuar një sërë pikash të rendit të ditës, e të cilat kryesisht kishin të bënin me përmirësimin e gjendjes së shërbimeve komunale, në të mirë të qytetarëve të kësaj komune. Fillimisht është diskutuar për caktimin e një lokacioni për shitjen e druve dhe vendosjen e sharrëxhinjve. Pas disa propozimeve, është vendosur të shikohet si opsion që për këtë qëllim të caktohet një lokacion në dalje të qytetit

prapa "Urës së Tabakëve".

Më tej, nga drejtori për Zhvillim Ekonomik, Ferdinand Kolaj, është raportuar për hapjen e thirrjes për grante, ndërsa që edhe janë formuar komisionet përkatëse për zhvillimin e këtij procesi. Lidhur me këtë temë, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka kërkuar që ky proces të jetë transparent, fer dhe në shërbim të plotë të bizneseve që vërtetë kanë nevojë për grante.

Me propozim të bordit të drejtorëve dhe me vendim të kryetarit Gjini në këtë takim janë formuar edhe disa komisione të përkohshme

komunale, të cilat, mes të tjerash, do ta bëjnë verifikimin e hapësirave reklamuese, verifikimin e pronave dhe bane-save komunale dhe krijimin e një strategjie afatgjatë për lirimimin e hapësirave publike. Në këtë takim është diskutuar dhe është kërkuar që sa më shpejt të gjendet mundësia edhe për rishikimin e hapësirave të tregjeve dhe të krijohen kushte më të mira për shitjen e prodhimeve bujqësore, në veçanti të bulmetit, pasi aktualisht këto produkte po shiten në kushte jo të mira hegjieno-sanitare.

Një lajm i mirë që doli nga ky



takim ishte nisja e procedurave për ndërtimin e rrugës që derëgon deri tek varrezat e martirëve në Çabrat. Me këtë rast, kryetari Gjini ka thënë se ky

është një projekt shumë i domosdoshëm, teksa ka shprehur bindjen e tij se rruga në fjalë do të jetë e gatshme deri në fillim të vjeshtës së këtij viti.

Fillojnë punimet për zgjerimin e "Rrugës rajonale R102, segmenti Komoran - Marinë"

Veseli: Rruga Klinë e Epërme - Komoran ta marrë emrin e Shaban Polluzhës

Me rastin e përrurimit të punimeve të rrugës Klinë e Epërme - Komoran, kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se kjo rrugë duhet ta marrë emrin e heroit kombëtar Shaban Polluzha. Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se kjo rrugë do të jetë e gjatë 17 kilometra dhe do të ketë katër korsi

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

DRENAS, 20 PRILL - Në fshatin Polluzhë të Komunës së Drenasit të premtën u inaugurua fillimi i punimeve për zgjerimin e "Rrugës rajonale R102, Komoran - Skenderaj, segmenti Komoran-Marinë". Të pranishëm në përrurimin e kësaj rruge ishin kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovi dhe kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari. Me rastin e fillimit punimeve të

rrugës Klinë e Epërme - Komoran, kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se në Kosovë po ndodh zhvillimi dhe ndryshimi pozitiv.

Veseli ka theksuar se për një shekull rresht në këtë rrugë kanë ecur heronjtë që bënë historinë e Kosovës, ata që punuan e luftuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, që nga çetat e Ahmet Delisë e Azem Bejtës, luftëtarët e Shaban Polluzhës, e deri tek njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Sot jemi këtu, në fillimin e punimeve të kësaj rruge, për ta nderuar kujtimin e tyre. Njëkohësisht, për ta dëshmuar



forcën tonë për të ecur përpara, forcën tonë për ta zhvilluar Drenicën, për ta zhvilluar Kosovën, për ta fuqizuar shtetin dhe garantuar të ardhmen e sigurt për fëmijët e Kosovës", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se ata që sot dyshojnë se në Kosovë po ndodhë ndryshimi pozitiv, janë të njëjtit që dje mendonin se nuk mund të çlirohet Kosova. "Ne e çliruam Kosovën. E bëmë shtet të pavarur dhe sovran. Do ta bëjmë shtet të zhvilluar ekonomikisht dhe vend dinjtoz për qytetarët e saj, me rrugë moderne, spitale, shkolla e vende pune për të rin-

jtë e Kosovës. Nuk ka forcë që mund të na ndalë në këtë mision të shenjtë", është shprehur kreu i Kuvendit.

Kryeparlamentari Veseli ka propozuar që kjo rrugë moderne, nga Klina e Epërme e deri në Komoran, të marrë emrin e heroit kombëtar Shaban Polluzha. "Shaban Polluzha ishte ai që shtroi për ne rrugën e lirisë. Sot ne e nderojmë këtë burrë të madh të Kosovës duke i vënë emrin e tij kësaj rruge moderne të Kosovës moderne dhe të zhvilluar", është shprehur Veseli. Ndërkaq ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka

thënë se sot po fillojnë punimet për zgjerimin e "Rrugës rajonale R102, segmenti Komoran - Morinë", e cila do të jetë e gjatë 17 kilometra. "Kjo rrugë do t'i ketë katër korsi dhe të gjitha elementet e tjera përcjellëse sipas standardeve të kërkuara të kohës, e buxhetuar me rreth shtatë milionë euro. Kompanive që do ta ndërtojnë ua bëjmë të qartë se do të jemi të vëmendshëm për të mos pasur vonesa në implementim të kontratave dhe që të mos ketë zgjatje e tejkalim të afateve për përfundimin e punimeve", ka thënë ministri Lekaj.

FMN-ja përgëzon Kosovën për stabilitet financiar

UASHINGTON, 20 PRILL (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, në kuadër të takimeve pranverore në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore në Uashington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), u takua me zëvendës drejtorin menaxhues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang. Me këtë rast, ministri Hamza e ka njoftuar Zhangun për progresin të cilin e ka arritur Kosova në zhvillimin e saj, me theks të veçantë në fushën e financave. Gjithashtu, ministri Hamza ka shprehur respektin dhe falënderimin për mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar ndër vite që i ka dhënë Kosovës. Ndërsa zëvendës drejtori

menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Tao Zhang, ka falënderuar ministrin Bedri Hamza për vizitën në Fondin Monetar Ndërkombëtar, si dhe e ka përgëzuar për trendet pozitive të zhvilluar në fushën financave, të cilat po ndodhin në Kosovë. Gjithashtu, ai u shpreh se Kosova falë punës profesionale dhe transparente të Ministrisë së Financave ka arritur të ketë stabilitet të plotë makro fiskal përkundër shumë kërkesave buxhetore dhe në të njëjtën kohë duke ndihmuar sektorin privat në zhvillim të tij përmes politikave fiskale. Zhang ka theksuar se kjo është një arritur e madhe që, pa qenë në program me FMN-në, është arritur nga vetë kosovarët.



Burgim për ish-inspektorët e Komunës së Prishtinës

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Ish-inspektorët e Komunës së Prishtinës janë shpallur të premtën fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Shefi i sektorit, Ismet Haliti, është dënuar me 3 vjet e 6 muaj burgim, për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe me 1 000 euro gjobë për armëmbajtje pa leje.

Në aktgjykimin e shpallur nga kryetari i trupit gjykues, Beqir Kalludra, Ismet Haliti i konfiskohet veturat dhe para në shumën prej 11 mijë eurosh si dhe pistole-

ta. Skënder Canolli është shpallur fajtor për keqpërdorim të pozitës zyrtare si dhe armëmbajtje pa leje, i cili është dënuar me 2 vjet e 6 muaj burgim si dhe me 1 000 euro gjobë për armëmbajtje pa leje. Po ashtu, Canolli i konfiskohet makina e tipit "Passat" dhe 10 mijë franga zvicerane.

Inspektorja Blerina Sylja është dënuar me dy vjet burgim për keqpërdorim të pozitës zyrtare, Vehbi Abdullahu, gjithashtu me dy vjet burgim, Blerim Ibishi me

dy vjet, Mergim Shala, me dy vjet dhe i konfiskohet banesa në lagjen "Kalabria", derisa Drita Rukiqi është dënuar me 1 vit e 6 muaj, Arbenita Ajeti 1 vit e 6 muaj, Ardian Muhadri me 1 vit burgim, Granit Cenaj 1 vit burgim.

Kurse afaristi Qemajl Pozhegu është dënuar me 20 mijë euro gjobë për falsifikim të dokumenteve. Të njëjtit akuzohen se nuk i kanë parandaluar ndërtimet kundërligjore ndaj objekteve të investitorëve. (Betimi për Drejtësi)



Ministri Tahiri: Bizneset, partnere për fuqizimin e sundimit të ligjit



PEJË, 20 PRILL (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në kuadër të kampanjës "Drejtësia dhe biznesi", që organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, konkretisht Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, ka takuar të premtën biznesmenët nga rajoni i Pejës.

Ministri Tahiri i ka informuar bizneset që gjithë kjo kampanjë është ndërmarrë në kuadër të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, që do të rishikojë jo vetëm legjislacionin,

por edhe rregullimin institucional në sektorin e drejtësisë, për të mundësuar qasje sa më të lehtë në drejtësi.

Në këtë kuadër, ministri Tahiri ka kërkuar të dijë më shumë për shërbimet që ofrohen nga profesionet e lira, duke bërë me dije se tashmë do të krijohet edhe një divizion i veçantë që do t'i mbikëqyrë këta profesionistë të kësaj fushe.

Për të pasur zgjidhje të kënaqshme që do të sjellin qartësi juridike dhe do të lehtësojnë afarizmin, ministri Tahiri ka kërkuar angazhimin e të gjithë

biznesmenëve për të qenë pjesë aktive e hartimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit. "Ne ju shohim juve si partnerë për arritjen e misionit tonë, për ta fuqizuar sundimin e ligjit dhe për të krijuar një klimë të sigurt të biznesit në vend", ka theksuar Tahiri. Sipas ministrit Tahiri, reformat të cilat janë duke u ndërmarrë në sistemin e drejtësisë prekin drejtpërdrejt klimën e të bërit biznes përmes rritjes së efektivitetit të organeve ligjzbatuese dhe rritjes së sigurisë juridike për bizneset dhe investitorët.

FSK-ja dhe NATO-ja koordinojnë aktivitetet

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), nën kryesimin e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Rrahman Rama, të premtën u zhvillua takimi i dytë zyrtar në mes të lidërshit të FSK-së dhe Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT) për Ministrinë dhe FSK-në. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, fillimisht ka

theksuar rëndësinë e këtij takimi ndërmjet udhëheqësve të FSK-së dhe të NALT-it, si organizatë dhe mekanizëm që punojnë shumë ngushtë bashkërisht, si dhe me një koordinim të vazhdueshëm në të mirë të zhvillimit dhe avancimit të FSK-së.

Drejtori i NALT-it, gjenerali Hoffmann, në fjalën e tij u interesua rreth pozicionit aktual të FSK-së, aktiviteve dhe planeve për të

ardhmen. Ndërsa zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjenerali Csombok, u fokusua në ndërveprimet e suksesshme ndërmjet KFOR-it dhe FSK-së, sidomos në ushtrimet e përbashkëta fushore. Ky ishte takimi i dytë me radhë i udhëheqësve të FSK-së dhe NALT-it, i cili mbahet me qëllim informimi, koordinimi dhe harmonizimi të aktiviteteve të përbashkëta.



Drejtori i GLZ-it dekorohet me Medaljen Presidenciale Jubilare

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një takim lamtumirës e ka dekoruar drejtorin e Zyrës së Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim (GIZ), James Macbeth Forbes, me Medaljen Presidenciale Jubilare të dhjetëvjetorit të pavarësisë, për kontributin e tij dhënë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Presidenti Thaçi e ka falënderuar atë

dhe të gjithë punëtorët e GLZ-it për punën dhe kontributin që kanë dhënë në një periudhë shumë të rëndësishme të shtetndërtimit tonë. "Kontributi juaj dhe i gjithë punëtorëve të GLZ-it ka qenë shumë i rëndësishëm për forcimin e shtetndërtimit në Kosovë. GIZ-i ka ndarë shumë mjete financiare dhe ekspertizë profesionale, duke ndihmuar në

forcimin e të gjitha fushave të rëndësishme për shtetin e Kosovës", ka thënë Thaçi.

Ndërsa drejtori i GLZ-it, James Macbeth Forbes, është shprehur falënderues për dekoratën që, sipas tij, u dedikohet të gjithë bashkëpunëtorëve të GLZ-it, që tash e shumë vjet kanë punuar për jetësimin e projekteve të ndryshme.

AAB-ja dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës arrijnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Kolegji AAB ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit akademik me Universitetin Shtetëror të Tetovës. Kjo marrëveshje më së shumti bazohet në shkëmbimin e stafit

akademik, shkëmbimin e studentëve, organizimin e përbashkët të aktiviteteve akademike dhe shkencore, aplikimin në projekte të përbashkëta si dhe shkëmbimin e praktikave të mira.

Rекtori i Universitetit të Tetovës, prof. dr. Vullnet Ahmeti, ka shprehur konsideratat më të larta për Kolegjin AAB duke e cilësuar institucionin më të madh dhe kredibil jopublik në Kosovë dhe rajon.

Ndërsa rektori i Kolegjit AAB, prof. asoc. dr. Lulzim Tafo, ka shprehur kënaqësinë që tashmë bashkëpunimi mes dy institucioneve është formalizuar përmes marrëveshjes.



Përrurohet libri tregime ‘Dritëhëna’

Nga Tefik SELIMI

Thonë, libri është dritare e botës. Është edhe dija e njeriut. Pa libër, si pa sy, si pa ardhmëri. Kush e adhuron librin, e do jetën. Me libër, njerëzit komunikojnë në mes vete. Afrohen dhe i rrëfejnë njëri-tjetrit dhimbjet dhe të mirat e jetës. Kjo është fuqia e librit. Pse jo? Me libër, njerëzit e pushtojnë botën. Bëhen miq të pandarë. Jo vetëm kaq. Edhe Rita Ademaj, tash nxënëse e shkollës fillore, ka hyrë në botën e librit. Ajo, duke lexuar vepra letrare, sikur ka hyrë në botën e "çudirave" dhe s'ndalet se lexuari. Andaj, ditë më parë, në Shtëpinë e Kulturës, në Shtime, para një numri mjaft të madh të adhuruesve të librit, u bë promovimi i veprës "Dritëhëna" e autores 11-vjeçare, Rita Ademaj, nga qyteti Shtime. Në këtë eveniment kulturor të promovimit të librit, morën pjesë shumë përfaqësues nga Komuna e

Shtimes, përfaqësues nga KFOR-i, drejtorë të shkollave, përfaqësues nga OJQ-të vendore, përfaqësues nga shoqëria civile dhe shumë qytetarë të këtij lokaliteti. Fillimisht, drejtori i Drejtorisë të Arsimit, Mensur Neziri, ka theksuar se komunës së Shtimes iu shtua edhe një emër i krijimtarisë letrare e artistike, duke vlerësuar Ritën, si një talente shembull për moshatarët e saj. "Autore me të re të komunës sonë, Rita Ademaj i uroj shumë suksese me rastin e promovimit të librit të parë të saj. Në komunën tonë kemi krijues të vegjël e të zotë, por edhe të talentuar, siç është edhe Omer Mahmuti, një krijues që premton. Por, Rita Ademaj, me tregimet e saj, ka arritur të botojë librin mjaft të mrekullueshëm dhe joshës për lexuesit në përgjithësi", është shprehur ai. Mensur Neziri ka bërë me dije se Komuna e Shtimes, si më parë, por edhe tash do t'i përkrahë talentet e rinj. Mësuesja Ibade Arifi, në fjalimin



e saj ka theksuar se do pa masë këtë shkollare të re. "Rita po më befason me talentin e saj. Është e re, por puna e saj, si shkollare, po tregon se premton. Te kjo shkollare e re kam vërejtur talentin e saj për shkrimet qysh kur ka qenë e vogël", ka thënë Arifi. Albin Mehmeti, recensent i librit në

fjalë, tha: "Autorja e re, Rita Ademaj, po vjen si një yll i ri në qiellin e letërsisë shqipe, me librin e parë të saj 'Dritëhëna'. Edhe pse vetëm 11-vjeçare, Rita bashkon talentin dhe dijen për të sjellë para nesh një përmbledhje me tregime, paralajmërim i një talenteje të re, që do të lë shenja të pashlyeshme në letërsinë tonë shqipe. Në tregimet e saj, Rita e vogël i mëson bashkëmoshatarët e saj, por edhe neve të rriturve se pasuria e vërtetë është edukata dhe dashuria e njeriut, dhe jo pasuria materiale", ka thënë ai. Mehmeti ka shtuar se Rita na këshillon që të jemi të kujdesshëm ndaj çdo gjëje, për vetën dhe prindërit, për kohën dhe jetën, për shokun dhe shoqen, për atdheun dhe ambientin, për të kaluarën dhe të ardhmen tonë. Ai ka theksuar se në tregimin "Dritëhëna", emër të cilin e bartë edhe vetë libri, kemi historinë e Artiollës jetime, e cila vdes e vetmuar. "Pra, ajo vdes nga uria dhe i

ftohtit. Përmes Artiollës së tregimit, Rita Ademaj, para nesh sjellë një tablo të hipokrizisë njerëzore, të cilët heshtin para Artiollave tjera. Artiolla e tregimit është vetëm njëra nga miliona Artiollat e tjera, të cilat vdesin para syve tanë, por edhe para syve të botës, të cilët Rita i quan botë vrastare. Dhe, kjo vdekja na bënë të ndjehemi fajtorë unë, ti e bota që na rrethon. Rita na mëson se vullneti është alfa dhe omega e çdo gjëje në këtë botë", ka thënë më tutje ai. Albin Mehmeti ka pohuar se Rita Ademaj, autore e re, është dëshmi e një rinie të shëndoshë kosovare, e cila me punën e saj shembull, na mëson shumë se si ta duam vetën, tjetrin e atdheun, mësimet që shpeshherë po i harrojmë. Në fund, Rita Ademaj tha se, nga këto fjalë të bukura, sikur po e ndjen vetën tepër të gëzuar e të emocionuar. "Jam tepër e gëzuar për këto fjalë miradije që u thanë për mua dhe veprën time", ka thënë autorja e librit.

‘I këndojmë lirisë’, me rapsodë nga të gjitha trojet shqiptare

KLINË, 20 PRILL (ER) - Në Festivalin Folklorik Gjithëkombëtar "I këndojmë lirisë", i cili mbahet në Klinë më 6, 7 dhe 8 qershor, do të marrin pjesë grupe artistike, rapsodë, valltarë e instrumentistë nga të gjitha trojet shqiptare. Drejtori i Festivalit, Dibran Fylli, në mbledhjen e Drejtorisë së Festivalit ka thënë se s'vjet në këtë festival do të marrin pjesë grupe artistike nga të gjitha trojet shqiptare, ndërsa seleksionimin do ta

bëjë Drejtoria Artistike në krye me Halit Gashin. Ndërkaq, skena do të dizajnohet profesionalisht ashtu siç e meriton ky festival gjithëkombëtar. Në këtë mbledhje u zgjodhën bartësit e grupeve punuese; sekretar i festivalit u zgjodh Ramadan Selimi, kurse kryeredaktor i gazetës "Lyrja" u zgjodh Enver Maloku. Ndërkaq Aziz Desku, drejtor Komunal i Ekonomisë dhe i Financave, ka paraqitur aspektet dhe koston e shpenzimeve të festivalit dhe procedurat e tenderimit.



Kosova, pjesë e ekspozitës ndërkombëtare të Bienales së Venedikut

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Në Galerinë Kombëtare të Kosovës është mbajtur të premten konferenca e organizuar me rastin e pjesëmarrjes së Kosovës në edicionin e 16 të Ekspozitës Ndërkombëtare të Bienales së Venedikut. Në këtë konferencë, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se që nga momenti kur MKRS-ja ka përzgjedhur Eliza Hoxhën që ta përfaqësojë Kosovën, këtë vit në Bienalen e arkitekturës në Venedik, ajo ka punuar rreth identifikimit të temës së Pavilionit të Kosovës dhe, bashkë me bashkëpunëtorët e saj, ka shtyrë përpara projektin i cili tani veç se do të fillojë të marrë formë në Venedik. "Për ne si shtet është shumë e rëndësishme të jemi në një ngjarje të tillë e cila shënon arritjet në arkitekturë, hapë tema dhe debate të reja që lidhen me qytetin, marrëdhënien e



njerëzve me të, proceset globale që e ndikojnë atë dhe vendimet politike që merren për të. Andaj ku ka më mirë se në një ngjarje të tillë si kjo, Kosova t'i shpalosë sfidat dhe rrëfimet e saj pas një viti mungese, mospjesëmarrje nga bienalja e kaluar", ka thënë Gashi. Po ashtu, ai ka thënë se "diplomacia kulturore dhe aktorët e saj

janë pjesë përbërëse dhe tepër e rëndësishme e shtetformimit dhe ndërtimit të imazhit në botë. Ministri Gashi ka folur edhe për rëndësinë e temës me të cilën do të përfaqësohet Kosova, duke thënë se rrëfimi për vitet e '90-ta është një rrëfim unik në sensin e mobilizimit dhe mbijetesës kolektive të shqiptarëve të Kosovës.

Gazmend Luboteni, kryetar i Këshilli Shtetëror të Cilësisë

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka mbajtur të premten takimin e parë konstituiv të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), ku në praninë e pesë anëtarëve vendorë të këtij Këshilli dhe në komunikim të drejtpërdrejtë (online) me tre anëtarët ndërkombëtarë, me shumicë të

votave, kryetar i KShC-së u zgjodh Gazmend Luboteni. Ministri Bytyqi, me këtë rast, ka uruar anëtarët e KShC-së për detyrën e re, për të cilën tha se është angazhim sa i rëndësishëm aq edhe me punë dhe përgjegjësi të lartë karshi interesave të komunitetit arsimor dhe qytetarëve të Kosovës. Ai ka theksuar se anëtarët

ndërkombëtarë të KShC-së do të kenë mandat pesëvjeçar, kurse për ata vendorë do të përcaktohet mandati trevjeçar apo pesëvjeçar. Anëtarët e KShC-së në prani të ministrit lexuan deklaratën e betimit, me të cilën u zotuan se do të kryejnë me përkushtim dhe përgjegjësi detyrën që u është besuar.



E jashtëzakonshme

Çifti me 14 fëmijë,
të gjithë janë djem

Një çift nga Kent County me 13 djem ka mirëpritur në jetë një tjetër fëmijë në familje. Jay dhe Kateri Schwandt janë bërë përsëri prindër të një djali. Çifti ende nuk i ka vendosur emrin foshnjës së tyre. Pas lindjes së 13 djemve, ardhja në jetë e vogëlushit ka vendosur famil-



jen Schwandt në titujt ndërkombëtarë. Djali më i madh i tyre është 25 vjeç dhe më i vogli, para të porsalindurit, është dy vjeç.

FOTO E DITES




Zonja e parë e ShBA-së, Barbara Bush, e cila ndërroi jetë këtë javë, shihet në fotografi me qenin e saj Millie në vitin 1990. /AP/

E rrallë

Breshkës i thyhet
guaska, e 'riparojnë'
me vida dhe lidhëse

Teksa përpiquej të shpëtonte nga qeni, një breshkë u rrëzua nga muri. Rrëzimi i kushtoi guaskës, e cila u thye në tri vende. Protagoniste e ngjarjes është një breshkë nga San Diego, në Kaliforni, ShBA. Fatmirësisht, historia e saj për-



fundon mirë. Pas tre orësh ndërhyrje, koraca u riparua në mënyrë rrethore falë përdorimit të vidave, lidhësve dhe stukos që përdoret zakonisht nga dentistët.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Babi, e sheh si është zbukuruar mami për ty?
Babi: Djali im, gratë nuk zbukurohen për burrat e tyre, por për inat të grave të tjera.

Programi i shfaqjes së filmave
në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në
ora 14:30

“BLACK PANTHER”
3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-
Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler




Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM
UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1
orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight




Në ora 21:00

“RED SPARROW”
(R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Ballafaqimi me persona të caktuar sot duhet të jetë sa më i qetë dhe pa asnjë emocion nga ana juaj. Kjo gjë do t'ju ndihmojë të kërkonti atë që doni.



DEMI

Ndiheni shumë të kënaqur nga vetja sot sepse investimi i bërë në një fushë të caktuar ka dhënë rezultatet e veta. Do ta ndani me miqtë këtë ndjesi.



BINJAKËT

Duhet të mësoni disa teknika relaksi sot sepse dita do të jetë e ngarkuar me situata të ndezura dhe mjaft të tensionuara.



GAFORRJA

Nëse nuk afroheni me personat që keni pranë do të krijoni ngecje në një projekt të rëndësishëm tuajin. Dikush po kontrollon hapat që hidhni.



LUANI

Sot keni ndrojtë të kërkonti ndihmë për një problem të lindur. Nëse e lini pas dore nuk do të mund të rikuperoni të gjithë kohen e humbur.



VIRGJERESHA

Mos lejoni askënd t'ju thotë se kush është gjëja më e rëndësishme për ju. E dini mjaft mirë se cilat janë prioritetet tuaja dhe nuk keni pse pyesni të tjerët.



PESHORJA

Sot mund të ndihmoni realisht personat që janë në nevojë. Një nismë e juaja do të pasohet nga shumë gjëra të bukura në vazhdim.



AKREPI

Kolegët kanë organizuar një festë surprizë për ju dhe për gjithçka keni arritur bashkërisht. Do të emocionoheni, gjë që ju ndodhë rrallë.



SHIGJETARI

Sot duhet të kërkonti më shumë vëmendje nga partneri. Rrini sa më shumë me familjen tuaj, sepse kohëve të fundit jeni distancuar nga familja.



BRICJAPI

Jeni në humor të mirë sot dhe prireni t'i bëni dhurata kujtdo që takoni. Do të këtë mjaft batuta në grupin tuaj shoqëror për ju.



UJORI

Jeni në udhëkryq dhe disi në panik për vendimet që do t'ju duhet të merrni. Kjo frikë e juaja do të reflektohet në çdo hap që do të bëni sot.



PESHQIT

Fëmijët janë shumë në humor në shoqërinë tuaj dhe sot do të kaloni kohë me ta. Jeni shumë i pëlqyer edhe nga shokët që keni.



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MAN UTD - TOTTENHAM

GG3+

ROCHDALE - BRADFORD

1

EIN. FRANKFURT - HERTHA

1

Llapi synon t'ia ndalë hovin Dritës

Llapi i Tahir Batatinës po synon ta zbresë nga froni skuadrën e Bekim Isufit, Dritën. "Kemi punuar maksimalisht për ndeshjen ndaj Dritës dhe do ta japim maksimumin për t'i marrë pikët e plota. Kemi mbetur pak larg objektivave, por ende jemi në garë dhe në këtë ndeshje do të luajmë pa presion", ka thënë Batatina

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 PRILL - KF Drita është duke kaluar nëpër një formë të jashtëzakonshme në Vala Superligën e Kosovës në futboll, çfarë e dëshmon edhe pozita e parë në renditjen tabelore. Megjithatë, Llapi po synon ta ndalë hovin e gilanave të dielën në ndeshjen derbi që zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Besianë. "Kemi punuar maksimalisht për ndeshjen ndaj Dritës dhe do ta japim maksimumin për t'i

marrë pikët e plota. Kemi mbetur pak larg objektivave, por ende jemi në garë dhe në këtë ndeshje do të luajmë pa presion", ka thënë trajneri i Llapit, Tahir Batatina, i cili më pas ka ftuar edhe shikuesit të jenë në numër sa më të madh për ta përkrahur skuadrën e tyre të zezë. "Nëse veç pak keni ndjenja për Llapin, të dielën të gjithë së bashku do të luftojmë për fitoren e radhës. Djemtë janë të motivuar dhe forma e tyre është shumë optimale. Do të shkojmë betejë pas betejë", ka deklaruar Batatina. Synime të mëdha në ndeshjen



derbi të javës së 29 ka edhe Drita e Gjilanit.

Një prej lojtarëve të kësaj skuadre ka thënë të premten për gazetë se ndaj Llapit synohet fitorja. "Llapi ka një skuadër të mirë me lojtarë cilësorë, por ne jemi në formë të mirë dhe kjo nuk na prish punë. Jemi të vetëdijshëm se është një ndeshje shumë e rëndësishme,

por jemi të përgatitur për të shënuar fitore. Mungesa nuk kemi për këtë ndeshje dhe jemi të vendosur të mos e ndalim rrugën drejt titullit kampion", ka thënë Fazliu. Në kuadër të kësaj xhiroje të shtunën takohen: Gjilani - Trepça '89 dhe Feronikeli - Liria, kurse të dielën, krahas derbit Llapi - Drita, zhvillohen edhe tri ndeshje të

Vala SUPERLIGA - Java e 28-të

Të shtunën takohen:

Gjilani - Trepça'89

Feronikeli - Liria

Të dielën takohen:

Llapi - Drita

Vllaznia - Prishtina

Besa - Drenica

Flamurtari - Vëllaznimi

LIGA E PARË - Java e 26-të

Të shtunën takohen:

KEK-u - Vushtrria

Fushë Kosova - Vitia

Ramiz Sadiku - Trepça

Kosova (P) - Onix Banja

Të dielën takohen:

Ballkani - Ferizaj

Kika - 2 Korriku

Bashkimi (K) - Rahoveci

Hajvalia - Dukagjini

tjera: Vllaznia - Prishtina, Besa - Drenica dhe Flamurtari - Vëllaznimi.



Sot garat e Gjinnastikës në Fushë Kosovë

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Federata e Gjinnastikës e Kosovës (FGJK) vazhdon me organizimin e garave për këtë vit. Sot (e shtunë) në sallën e Edukimit Fizik dhe Sportit në Fushë Kosovë në Shkollën Mihajl Grameno nga ora 11:00 do të mbahet gara në Gjinnastikën Artistike për meshkuj dhe femra. Organizimi i kësaj gare do të jetë në mes FGJK-së, KGJ "Fushë Kosova" dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në këtë Komunë. Ndërsa klubi i "Fushë

Kosovës" është i përgatitur maksimalisht për këtë garë, kurse synon të rrëmbejë edhe medalje. "Në bashkëpunim me Departamentin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Fushë-Kosovës kemi bërë përgatitjet e duhura për organizimin e garave në të cilat do të jemi nikoqirë dhe presim që gjinnastët e klubit tonë të arrijnë të korrin rezultate, pasi jemi përgatitur maksimalisht për këto gara", ka thënë trajneri Sherife Aliçaj-Qerimi, për "Epokën e re".

Kroacia dhe Kosova vazhdojnë bashkëpunimin në Bodybuilding dhe Fitnes

PRISHTINË, 20 PRILL - Drejtuesit e Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kroacisë, të prirë nga kryetari Damin Siser dhe të shoqëruar nga kryetari i Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kosovës (FBBFK), Esat Lata, si dhe sekretari i përgjithshëm, Sabri Dragusha, vizituan Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK). Ata janë pritur nga nënkryetari Gazmend Maxhuni dhe zyrtari për media, Kushtrim Krasniqi. Maxhuni shprehu gatishmërinë e KOK-it për të përkrahur FBBFK-në, në veçanti përmes organizimit të kurseve për trajnerë dhe administratorë të sportit, si vazhdimësi e projekteve të fituara nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Kryetari i Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kroacisë, Damin Siser, duke falënderuar për pritjen e bërë, shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me KOK-un për të ndih-



muar FBBFK-në, në ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve, gjyqtarëve dhe administratorëve të sportit. Ai uroi që një kurs i tillë të mbahet sa më parë edhe për FBBFK-në. Nga ana e tij, kryetari i Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kosovës, Esat Lata foli për kontributin e madh ndër vite të dhënë nga homologët e tyre kroat, e po ashtu në luajtjen e rolit kyç të sukseseve të kampioneve të Evropës dhe botës, Gentiana Beqa. Zyrtarët kroatë po qëndrojnë në Kosovë, në ligjërimit për seminarin e gjyqtarëve dhe të antidopingut të organizuar nga FBBFK-ja.

Khaka, Wengerit: Ëndërr të luaja për ju

Londër, 20 prill - Mesfushori shqiptar Granit Khaka ka falënderuar trajnerin e tij tek Arsenal, Arsene Wenger, ndërsa thekson se ishte një ëndërr e bërë realitet të ishte nën menaxhimin e francezit.

"Një ëndërr e bërë realitet ishte të luaja për ju dhe nder t'ju kisha trajner. Faleminderit trajner, një leg-

jendë e madhe. Tani duhet të përfundojmë këtë sezon së bashku në mënyrën më të mirë të mund-

shme dhe ta përfundojmë me një trofe më shumë", ka shkruar Khaka në rrjetet sociale.

Kryetari Haziri nderon me mirënjohje veteranin e futbollit, Haqif Shkodrën

GJILAN, 20 PRILL - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka nderuar me mirënjohje të premtën Haqif Shkodra, në shenjë falënderimi për kontributin e tij të çmuar dhe merita të veçanta në sport, veçanërisht në futboll. "Haqif Shkodra është

një nga futbollistët më të spikatur në historinë e futbollit të Gjilanit duke qenë edhe lojtar në ekipin junior të përfaqësueses së Jugosllavisë për një kohë të gjatë. Së bashku me komunitetin shqiptar në Kanada, Haqifi vazhdon ta mbajë gjallë traditën e

futbollit, duke luajtur e përkrahur si trajner disa ekipe futbollit të komunitetit shqiptar atje", thuhet në njoftimin e Komunës së Gjilanit. Ndërsa kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, theksoi rëndësinë e sportit si ndërtues i imazhit të

mirë të vendit tonë dhe kombit nëpër botë. "Diaspora në veçanti i jep shpirt e zemër vendit tonë. Edhe gjatë vizitës sime të fundit në Kanada, kam parë punën e mirë që komuniteti ynë e bënë atje. Jeni meritore!", ka thënë Haziri.



Wengeri largohet nga Arsenalin pas 22 vjetësh

LONDËR, 20 PRILL - Trajneri Arsene Wenger ka habitur futbollin, duke njoftuar se ai, më në fund, do të japë dorëheqje si trajner i Arsenalit në fund të sezonit, pas 22 vjetësh në krye të londinezëve. Francezi 68-vjeçar, i cili u bashkua me Arsenalin në vitin 1996, ka shkruar një deklaratë emocionale për tifozët e klubit, duke njoftuar largimin e tij, duke u falënderuar ata për dashurinë dhe mbështetjen. Wenger e lëshon këtë "bombë" përpara ndeshjes së Premier Ligë, që Arsenalin do të luajë ndaj West Ham në "Emirates", të dielën pasdite. Ka pasur trazira të hapura në "Emirates" gjatë viteve të fundit, pas dështimit të francezit për të fituar titullin e ligës, që nga viti 2004. Ai ka fituar, megjithatë, 10 trofe të mëdhenj gjatë kohës së tij në veri të Londrës dhe do të mbahet mend si trajneri më jetëgjatë i klubit. Ai ka thënë për faqen zyrtare të Arsenalit: "Pas shqyrtimit të kujdesshëm dhe diskutimeve me me klubin, mendoj se është koha e duhur për mua që të largohem në fund të sezonit. I jam mirënjohës klubit, që kam pasur privilegjin t'i shërbej Arsenalit për shumë vite të paharrueshme. E kam menaxhuar klubin me përkushtim dhe integritet të plotë. Dua të falënderoj stafin, lojtarët, drejtorët dhe tifozët, që e bëjnë këtë klub kaq të veçantë. Iu bëj thirrje tifozëve tanë



të qëndrojnë prapa ekipit, për të qenë në një nivel të lartë. Të gjithë dashamirët e Arsenalit duhet të kujdesen për vlerat e klubit. Dashuria dhe mbështetja ime për këtë klub do të jetë përgjithmonë". Ndërkohë, aksionari i shumicës së Arsenalit, Stan Kroenke, e përshkroi këtë si "ditën më të vështirë, që kemi pasur ndonjëherë". Amerikani ka deklaruar: "Kjo është një nga ditët më të vështira që kemi pasur ndonjëherë, në të gjitha vitet tona në sport. Një nga arsyet kryesore që morëm me Arsenalin ishte për shkak të asaj që Arsene ka sjellë në klub, brenda dhe jashtë fushës. Jetëgjatësia dhe qëndrueshmëria e tij gjatë një periudhe të tillë, në nivelin më të lartë të lojës, nuk do të përputhen kurrë. Arsene ka bërë diçka të pashembullt dhe ne do t'i jemi gjithmonë mirënjohës atij. Gjithkush që e do Arsenalin dhe kushdo që e do futbollin i detyrohet atij një borxh mirënjohjeje. Tre tituj

të Premier Ligë, duke përfshirë një sezon si i pamposhtur, shtatë fitore në 'Fa Cup' dhe 20 vite të njëpasnjëshme në Ligën e Kampionëve, janë një rekord i jashtëzakonshëm". "Ai, gjithashtu, ka transformuar identitetin e klubit tonë dhe të futbollit anglez, me vizionin që ka për këtë lojë magjike. Ne kemi ambicie të larta për të ndërtuar mbi qëndrimin e jashtëzakonshëm të Arsene dhe për të nderuar vizionin e tij, duke siguruar që Arsenalin të konkurrojë dhe të fitojë çmimet më të mëdha dhe më të rëndësishme në futboll. Tani duhet të përqendrohemi në një përfundim të fortë të sezonit dhe t'u kërkojmë miliona tifozëve tanë në botë që të bashkohen me klubin për të paguar 'haraçin' e duhur ndaj një prej më të mëdhenjve të historisë së Arsenalit", ka deklaruar ai. Arsene Wenger e ka menaxhuar Arsenalin në 22 vite radhazi, ku ka fituar tre tituj të Premier Ligë dhe shtatë "FA Cup". 68-vjeçari ka kaluar një kohë të vështirë të vonshme, me tifozët gjithnjë e më shumë të frustruar me Arsenalin, që mbetet pas rivalëve të tjerë të Premier Ligë. "Topçinjtë" e humbën kualifikimin në Ligën e Kampionëve vitin e kaluar dhe duket se do të ketë edhe një herë këtë fat, përveç nëse Wenger e çon Arsenalin në lavdinë e "Evropa Ligë", në Lyon, në fund të sezonit.

Warriorsi, shumë i fortë për Spursin

OAKLAND, 20 PRILL - Tri fitore bindëse në NBA. Spikat më shumë suksesi i kampionëve në fuqi të Golden State Warriorsit. Skuadra e trajnerit Steve Kerr bëri ligjin ndaj San Antonios edhe në "AT&T Center" të Teksasit duke marrë një fitore me peshë që e çoi në 3-0 serinë e çerekfinaleve të Perëndimit mes tyre me Warriorsin që tashmë është vetëm një fitore larg kualifikimit në raundin tjetër. Spursi nuk bën aspak rezistencë ndaj Golden States që sërish nuk e ndjeu mungesën e Stephen Curryt, pasi Kevin Durant dhe Klay Thompson treguan edhe një herë tjetër të gjithë potencialin e tyre. Debutimi në stol në një ndeshje "play-off" i zëvendësit të Popovichit, italianit Ettore Messina, nuk ishte fatsjellës për San Antonion që u dorëzua me rezultatin 110-97. 26 pikë, 6 asistime dhe 9 rikuperime koleksioni në total Kevin Durant, ndërsa Thompsoni shtoi 19 pikë të tjera. Në krahun tjetër LaMarcus Aldridge i vetëm nuk mund të bënte më shumë, duke e mbyllur ndeshjen me 18 pikë, 4 asistime dhe 10 rebounde, raporton "Supersport". Ashtu si Golden State hodhi një hap të sigurt drejt kualifikimit edhe New



Orleans Pelicans. Në "Smothie King Center", e udhëhequr nga dyshja Nikola Mirotic-Anthony Davis dhe falë një periode të parë fantastike të cilën e mbylli në avantazhin e 16 pikëve, New Orleansi triumfoi me rezultatin 119-102 ndaj Portland Trail Blazersit, duke e çuar në 3-0 serinë e përballjeve mes tyre. 30 pikë realizoi malazezi i natyralizuar spanjoll Nikola Mirotiq, ndërsa Anthony Davis me 28 pikë 2 asistime dhe 11 rikuperime poshtë tabelës gjithashtu ishte përcaktues. Fitore e madhe e Philadelphia 76-

ers brenda në "American Airlines Arena" përballë Miami Heat. 128-108 në favor të skuadrës nga Pensylwania ishin shifrat e kësaj sfide me Philadelphian që iu fal lojës së shkëlqyer në grup pasi plot 6 basketbollistë të 76-ers kapën një kuotë pikësh me 2 shifra në këtë ndeshje. Një fitore që i jep kryesimin e serisë në 2-1 skuadrës së trajnerit Brown. Të pamjaftueshme 23 pikët e slovenit Goran Dragic për Miamin, ndërkohë që të Philadelphia më të mirë mbi parket ishin kamerunasi Embiid me 23 pikë dhe italianin Marco Bellineli me 21.

SHKURT

Gjysmëfinalët e Kupës: Mitrovica - Kosova (P) dhe Malisheva - Hajvalia

Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK-së) të premtën është bërë tërheqja e shortit për gjysmëfinalen e Kupës së Kosovë futboll në konkurrencën e femrave. Në gjysmëfinale do të takohen: Mitrovica - Kosova (P) dhe Malisheva - Hajvalia. Ndeshjet zhvillohen me sistem vajtje-ardhje, kurse ndeshjet e para janë paraparë të luhen në mesjavën e ardhshme.

Messi rrezikon Botërorin

Kur vesh fanellën e Argjentinës, Messi duket si një hije i vetvetes dhe këtë frikë e kanë të gjithë në Argjentinë, kur duhen më pak se dy muaj nga fillimi i kampionatit botëror Rusi 2018. Mediet spanjolle e kanë ngritur alarmin sepse ylli i Barcelonës ka lëshuar sinjalet e para të problemeve. Shqetësimet e para kanë nisur më 14 mars në ndeshjen për 1/8 të finaleve të Ligës së Kampionëve kundër Chelseas, kur 'pleshti' shfaq problem në rrëzë të kofshës. E njëjta gjë u përsërit katër ditë më vonë në ndeshjen me Atletiko Bilbao. "Që nga ajo kohë ka ngadalësuar hapat dhe duket sikur ka bërë anestezi, pasi nuk ka shkëlqim dhe lëvizje shpërthyes në lojën e tij", shkruan La Nacion. Provat pa shkëlqim të Ligës së Kampionëve kundër Romës kanë reflektuar edhe më shumë lodhjen e tij. Në fakt në muajin e fundit Messi është parë më shumë në bankinë, madje në ndeshjet miqësore me Italinë e Spanjën ai nuk zbriti në fushë. "Nuk është mirë, është në limite", shkruan një burim pranë futbollistit, duke rritur edhe më shumë ankthin te tifozët. Problemet që po shfaq Messi, të njëjtat që e kanë penguar të luajë edhe më parë, duhen trajtuar me shumë kujdes, sepse "pleshti" nuk është më dhe aq i ri dhe nga Botërori na ndajnë vetëm dy muaj. Nënvlërësimi i problemeve të shfaqura mund të shkaktojë tërheqje të gradës më të rëndë që do të bënin të pamundur aktivizimin e tij në botëror. Deri në përfundimin e këtij sezoni duhen edhe pesë ndeshje dhe në harkun e 25 ditëve vendosen dy trofe, Kupa e Mbretit dhe titulli kampion. Barcelona ka nevojë për të dhe Messi duhet t'i shtrëngojë dhembët.

Unitedi kërkon 140 milionë për Pogban

140 milionë euro, ky është çmimi i Paul Pogbas për klubet që duan ta transferojnë gjatë verës. Pogba dhe Manchester Unitedi mund t'i ndajnë rrugët në fund të sezonit aktual, për faktin se francezi nuk pëlqehet më nga trajneri Jose Mourinho, me të cilin marrëdhëniet nuk janë më si më parë. "Daily Mail" raporton se "Djajtë e Kuq" tashmë i kanë caktuar edhe çmimin francezit - duhet të paguajnë 140 milionë euro për gjitha klubet që e duan 25-vjeçarin. Raportohet se Paris Saint Germaini është skuadra më e interesuar për shërbimet e ish-mesfushorit të Juventusit, emri i të cilit për një kohë të gjatë lidhet edhe me Real Madridin.

Marquezi pranon gabimin, po nuk pendohet

Marc Marquez duket se nuk është penduar aspak për atë gjestin e gabuar ditë më parë, duke nxjerrë nga pista Valentino Rossin. Piloti spanjoll i Hondas ka thënë se i kishte kërkuar ndjesë italianit, por shprehu bindjen se do të tentojë sërish të njëjtën gjë. "Në atë episod gabova dhe i kërkoja falje Valentinos. Bëra gjithçka që munda dhe do të tentoj sërish ta bëj. Ky është stili im i të garuarit, kërkoj gjithmonë të shkoj në limite", deklaroi piloti spanjoll. Marquezi më tej 'thumboi' kolegun italian, duke thënë se nuk ka aspak frikë kur është mbi motor dhe në pistë. "Rossi ka frikë kur është në pistë? Unë nuk kam frikë. Nuk kam pasur kurrë kur kam qenë mbi motor", ka thënë Marquezi.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Njësia e Personelit / Jedinica za Personal / Personnel Unit



01Nr./br. 1346
Me dt./dana.20.04.2018
Rahovec/Orahovac

Form. MAP- SHCK-02
Obraz. MJU-CSK-02

SHPLLJA E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucion/ **Komuna e Rahovecit**/kërkon të punësoj në Zyrën ligjore pranë Zyrës së Kryetarit të komunës.
Institucija / Opština Orahovac želi da regrutuje u Pravna Kancelarija pri Kancelarija Predsednika Opštine .

Titulli i vendit të punës/ Naziv radnog mesta:

- Zyrtar ligjor 2 -(1 pozitë)
- Pravni Službenik/ica 2 (1 položaj)

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: P2-G9 / koeficienti i pagës 7.
Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta: P2-G9/ koeficijent plate 7.

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto : LI/060

Detyrat dhe përgjegjësitë/ Poslovi i odgovornosti :

[Shënimi saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore/
(Ukratko i Tačno naznačite osnovne odgovornosti):

- ofron këshilla juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale (Kryetari i komunës, Kuvendi Komunal, Zyra e prokurimit, Komiteti, Komisionet etj)-15%
- përpilon vendime, aktevendime, pëlqime, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresat tjera për organet komunale dhe trupat e formuara nga organet komunale-25%
- harton dhe harmonizon aktet juridike nënligjore që bien në kompetencë të komunës si psh. Rregulloret komunale, Vendimet, Urdhëresat administrative etj-10%
- merret me shqyrtimin e ankesave të drejtuara Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale -10%
- ofron këshilla profesionale të interpretimit të akteve juridike për çështjet e parashtruara nga organet komunale dhe trupat e formuara nga organet komunale-5%
- kujdeset për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative Kryetarit të komunës, drejtorive komunale dhe zyrës së prokurimit-5%
- kujdeset për shqyrtimin, hartimin dhe harmonizimin me kohë të akteve nënligjore dhe të akteve tjera juridike të komunës -5%
- kujdeset për shqyrtimin, hartimin dhe harmonizimin me kohë të akteve nënligjore dhe të akteve tjera juridike të komunës -10%
- me autorizimin e shëfit të zyrës ligjore merr pjesë në punët e Kuvendit të Komunës, trupa punuese të kuvendit të komunës dhe të organeve tjera komunale sipas kërkesës zyrtare, për të dhënë mendime profesionale për çështje konkrete nëse kërkohet nga kryesuesi i KK-së dhe Kryetari i Komunës-5%
- me autorizimin e shëfit të zyrës ligjore merr pjesë në punët e takimit të Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive komunale dhe trupave punuese të formuara nga Kryetari i Komunës, për të dhënë mendime profesionale për çështje konkrete nëse kërkohet nga Kryetari i Komunës ose organet gjegjëse-5%
- me autorizimin e shëfit të zyrës ligjore, merr pjesë në komisionet e formuara ad hoc nga kryetari i komunës ose organet tjera të komunës për çështje të caktuara-2%
- paraqet raporte punë mujore, periodike dhe vjetore-2%
- kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit që janë në pajtim me ligjin-1%

